



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 32 të Ligjit Nr. 08/L-153 mbi edukimin në fëmijërinë e hershme , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.17 e datës 3 gusht 2023 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.10.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QËNDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË FSHATRAT E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave , zvogëlimet e tarifave dhe aplikimi i tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Institucionet parashkollore në fshatrat e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Institucionet parashkollore funksionale në fshatrat e Komunës së Lipjanit , në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej **30.00 €**.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4

Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestaret e fëmijëve do te paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumë prej 21.00 €.

Për fëmijën e tretë pa pagesë

Neni 5

Aplikimi i Tarifave

Aplikimi i tarifave të cekura në nenin 2 dhe 4 të këtij Vendimi do të fillojë menjëherë, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Te institucionet parashkollore të reja, vendimi për aplikim të tarifave do të zbatohet, pas fazes testuese 6 mujore.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.15-610/07-52751 i dates 28.09.2022 mbi caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në dy institucionet parashkollore në fshatrat Gadime dhe Sllovi.

Nr. 15-600/01-61654

Lipjan, më 30.10.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

